

KONVENTA PËR INTEGRIMIN EUROPIAN

Grupi i Punës IV (Mjedisi)

Sesioni 3, Tema: "Ndikimi mjedisor i zhvillimit të burimeve natyrore dhe politikave të BE-së për zhvillimin e qëndrueshëm"

Fier

Zhvillimet aktuale

Në Shqipëri Fieri përbën një nga qytetet më të pasura me burime natyrore. Nafta dhe gazi natyror janë dy burimet hidrokarbure më të rëndësishme të vendit, dhe zona e Patos-Marinzës është fusha më e madhe e naftës në të gjithë Ballkanin. Sipas statistikave rezultojnë që deri më 1 janar 2014, janë prodhuar rreth 55.498.458,31 ton naftë, që do të thotë 68.49 % të rezervave të nxjerrëshme ose 12.68 % të rezervave gjeologjike.

Studimet tregojnë se flora përreth zonës së Patos-Marinzës ku zhvillohen aktivitetet kryesore nxjerrëse të naftës është mjaft e ndotur si pasojë e derdhjes së ujrave të industrisë së naftës në Lumin Gjanicë që sjell edhe ndotjen e lumit Seman dhe specieve ujore të zonës. Për më tepër industria e naftës e zhvilluar në Fier mund të ketë edhe impakt të drejtpërdrejtë mbi jetën e qytetarëve të cilët banojnë pranë puseve të prodhimit të naftës në zonën e Patos Marinzës, siç ndodhi në Prill 2015 nga shpërthimi i dy puseve të naftës ku ushtron aktivitetin Bankers Petroleum.

Veprimtaria e zhvillimit të burimeve natyrore është e mangët në Shqipëri, pasi nuk bazohet në aspektet ekonomike, shoqërore e mjedisore të Zhvillimit të Qëndrueshëm. Fusha e burimeve natyrore mbetet problematike për t'u zgjidhur pasi dhe korrupsioni është më i madh aty, kështu që duhet më shumë punë dhe bashkëpunim për të arritur rezultate pozitive.

Probleme & Rekomandime

Zhvillimi i qëndrueshëm

Burimet natyrore shqiptare nuk mund të konsiderohen se zhvillohen sipas parimit të zhvillimit të qëndrueshëm në kuptimin e ndërthurjes së elementit mjedisor, ekonomik dhe shoqëror për arsyet e mëposhtme:

- **Në aspektin Mjedisor**, siç vihet në dukje nga studimet përkatëse, mjedisi shqiptar është mjaft i ndotur nga industrinë e shfrytëzimit të burimeve natyrore, naftës, gazit dhe mineraleve. Gjithashtu aksidentet e shpeshta që shoqërojnë zhvillimin e këtyre aktivitetëve dëshmojnë se nuk merren masat e nevojshme parandaluese për mbrojtjen e mjedisit nga degradimi. Nga ana tjetër nuk ka ndonjë provë të dukshme se të ardhurat e përfituara nga

shfrytëzimi i burimeve natyrore janë shpenzuar për investime në krijimin e teknologjive të reja të cilat respektojnë dhe ruajnë mjedisin.

- **Në aspektin Ekonomik** vihet re se marrëveshjet hidrokarbure të lidhura nga shteti shqiptar me shoqëritë private prodhuese të naftës shqiptare parashikojnë përqindje shumë të ulta fitimi për shtetin shqiptar, duke bërë që shfrytëzimi i burimeve kaq të vlefshme natyrore, të cilat janë dhe shumë të vështira për t'u ripërtëritur, të mos paraqesë leverdi të madhe ekonomike për Shqipërinë në krahasim me dëmin e shkaktuar. Kjo praktikë rezulton gjithashtu të jetë poshtë standardeve që zbatohen në vendet e BE-së për të njëjtin lloj aktiviteti, si p.sh Kroacia, dhe më pranë standarteve të vendeve të Afrikës. Gjithashtu nuk mund të thuhet se në zonat e naftës apo në zonat e minierave ka zhvillim dhe përmirësim ekonomik të popullatës vendase apo se janë kryer investime domethënëse në këtë drejtim.
- As në **aspektin Shoqëror** nuk ka një rritje të dukshme të nivelit të jetesës në zonat ku shfrytëzohen burimet natyrore. Të ardhurat e përfituara nuk duken të jenë investuar në përmirësimin e infrastrukturave ezksituese apo në ndërtimin e infrastrukturave të reja që përmirësojnë kushtet e jetesës së banorëve të zonës të tilla si struktura shëndetësore, banimi apo të tjera të ngjashme. Përkundrazi banorët e zonave të naftës apo minatorët e minierave ankohen shpesh se jeta e tyre është në rrezik për shkak të këtyre aktiviteteve.

Në këto kushte është e domosdoshme që Shqipëria të miratojë dhe të zbatojë politika konkrete të shfrytëzimit të burimeve natyrore sipas parimit të zhvillimit të qëndrueshëm dhe të marrë të gjitha masat nevojshme për respektimin e aspektit mjedisor, ekonomik dhe shoqëror.

Detyrimet e Shqipërisë në kuadër të Be-së

Shqipëria duhet të përafrojë legjislacionin e saj me legjislacionin e BE-së në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore. Deri më tani Shqipëria nuk ka miratuar asnjë strategji mbi zhvillimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe legjislacioni shqiptar për mbrojtjen e mjedisit është ende larg standarteve të BE-së. Për këto arsye Shqipëria duhet të përmbushë të paktën detyrimet e mëposhtme:

- Miratimin e Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit të Qëndrueshëm të Burimeve Natyrore;
- Përafrimin e legjislacionit Shqiptar me Direktivën Europiane 2008/99/EC "Për mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet legjislacionit penal" që parashikon një listë shkeljesh mjedisore që duhen trajtuar nga shtetet antare si krime mjedisore dhe të dënohen si vepra penale.
- Zbatimin e politikës së menaxhimit të mbetjeve në përputhje me standartet e BE-së, veçanërisht përsa i përket mebtjeve të rrezikshme;
- Arritjen e Standarteve të BE-së përsa i përket kontrollit të ndotjes industriale, që aktualisht lë shumë për të dëshiruar në Shqipëri (masat parandaluese nuk zbatohen, gatishmëria ndaj rreziqeve nuk zbatohet, vetë monitorimi nuk është i besueshëm dhe kontrollet shtetërore nuk janë efektive) nëpërmjet Miratimit të Ligjit për kontrollin e rreziqeve të aksidenteve të mëdha industriale, që duhet të përfarohet me Direktivën Evropiane 96/82/EC.
- Përafrimi me standartet e BE-së për sigurinë e operacioneve të naftës dhe gazit të tilla si Direktiva e BE-së 2013/30/EU. E domosdoshme në këtë kuadër është ndryshimi i ligjit nr. 7746, datë 28.07.1993 i cili rregullon veprimtarinë e kërkimit dhe prodhimit të naftës dhe gazit. Ky

ligj është i vjetër dhe i paplotë, përmban disa parime të përgjithshme por nuk përfshin rregulla të qarta teknike mbi procedurën e kërkim-prodhimit, teknologjinë e përdorur apo rregullat për mbrojtjen e mjedisit, në ndryshim p.sh nga ligji për sektorin minerar i cili është më i plotë dhe i detajuar.

Detyrimet e Konventës së të Drejtave të Njeriut

Shqipëria ka një sërë detyrimesh të tjera edhe si anëtare e Konventës së të Drejtave të Njeriut (“**Konventa e Strasburgut**”). Këto detyrime vijnë si pasojë e disa vendimeve të fundit të marra nga Gjykata e Strasburgut që prekin edhe fushën e mbrojtjes së mjedisit, e cila ka konsideruar se disa aksidente madhore mjedisore përbëjnë shkelje të të drejtave të njeriut si e drejta e jetës dhe e drejta e gëzimit të jetës familiare dhe private (çështja Öneriyıldız kundër Turqisë).

Gjykata e Strasburgut ka detyruar shtetet anëtare të ndjekin disa parametra dhe rregulla të caktuara gjatë zhvillimit të aktiviteteve të rrezikshme industriale në territorin e tyre, të tilla marrja e masave për rregullimin, kontrollin dhe sigurinë e aktiviteteve të rrezikshme edhe kur zhvillohen nga privatë, mbrojtja e banorëve të zonave ku zhvillohen aktivitetet e rrezikshme edhe kur këta të fundit kanë ndërtuar në mënyrë të paligjshme, informimi i publikut për rrezikshmërinë e aktiviteteve etj.

Në situatën aktuale, shteti shqiptar nuk i përmbush në mënyrën e duhur detyrimet e rregullimit, kontrollit, garantimit të zhvillimit të këtyre aktiviteteve në mënyrë të parrezikshme për jetën e njeriut dhe rezulton se ka një mungesë të theksuar informacioni mbi rrezikshmërinë e këtyre aktiviteteve. Për këtë arsye është e domosdoshme që shteti shqiptar të zbatojë standartet e kërkuara nga Konventa e Strasburgut, të ushtrojë të gjitha kontrollet e nevojshme dhe të marrë masat parandaluese dhe ndëshkuese për shmangien e situatave të rrezikshme të tilla si shpërthimi i puseve të Bankers-it ose aksidente të ngjashme në fushën e minierave.

Pjesëmarrësit në Sesionin 3, Grupi i Punës IV: Institucione Shtetërore dhe Shoqëri Civile

Institucionet Shtetërore:

Inspektoriati Mjedisor i Shtetit (Fier): Agron Basholli, Drejtor ; Vllazrim Mahmutaj; Altin Tasi;

Florjan Boçova; Antoneta Naçi; Andi Çullhaj; Denis Vogli; Elinor Shani; Pandeli Sema; Agur

Srenozi; Dritan Koroveshi

Drejtoria Rajonale e Mjedisit : Edvin Bixha ; Besmir Faslliaj; Valbona Gremi; Ervin Buzi

Kompani private, Shoqëri Civile, Media

Ekspertët e Grupit të Punës- Z. Juraj Mesik, Znj. Holta Ymeri



Bankers Petroleum – Znj. Rubensa Sanka

Gazeta “Dita”- Znj. Entela Resuli

Alb365 – Z. Xhemil Behanaj

Gazeta “Shekulli” – Z. Alfred Guraj

Ora News- Z. Çaku Tafa